



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS**

Tiranë më: 28.05.2025

Thirje Nr. 1 për Bashkëpunorë

1. Informacion i Përgjithshëm

Tipi i kontratës Me kohë të pjesshme

Projekti: “Kryerja e shërbimeve me fonde buxhetore në kuadër të Projektit për përmirësimin e aksesit të barabartë në shërbimet publike me standard të lartë nëpërmjet OPERACIONIT GOVTECH”

Kohëzgjatja e Kontratës Qershor 2025 – Nëntor 2025

Gjuha e kërkuar Shqip dhe Anglisht

Gadishmëria I/E gatshëm për të udhëtuar edhe jashtë Tiranës

Universiteti i Tiranës, kërkon të angazhojë bashkëpunorë të jashtëm në cilësinë e ekspertit, në përmbushje të detyrimeve kontraktuale të rrjedhura nga kontrata e shërbimit me Nr 1235/9 Prot, datë 19.05.2025, për projektin e bankës Botërore “Kryerja e shërbimeve me fonde buxhetore në kuadër të Projektit për përmirësimin e aksesit të barabartë në shërbimet publike me standard të lartë nëpërmjet OPERACIONIT GOVTECH”, me objektiva specifike:

1. Ngritja e kapaciteteve të drejtuesve të shkollave dhe specialistëve të ZVAP-eve për menaxhimin dhe integrimin e aftësive numerike në procesin mësimor për klasat I-III. Përmes trajnimeve, drejtuesit do të aftësohen për të mbështetur mësuesit në përdorimin efektiv të SmartLab-ve dhe për të garantuar një mjedis të përshtatshëm për zhvillimin e aftësive numerike.

2. Trajnimi i mësuesve të TIK-ut në përdorimin e inteligjencës artificiale në mësimdhënie dhe përmirësimi i aftësive themelore digjitale dhe numerike të nxënësve, të cilat janë thelbësore në shoqërinë e sotme.

3. Zhvillimi profesional i mësuesve të arsimit fillor përmes trajnimeve mbi kompetencat digjitale bazuar në standardet profesionale të TIK-ut. Mësuesit do të aftësohen në përdorimin e infrastrukturës SmartLab dhe aplikimin e metodologjive të avancuara në mësimdhënie për të përmirësuar rezultatet e nxënësve”.

Rezultatet e pritshme

Eksperti pritet të bashkëpunojë për përmbushjen e detyrave të mëposhtme:

-Shqyrtimi i literaturës bashkëkohore në lidhje me testimin e nxënësve të klasave të para, të dyta dhe të treta;

-Hartimi i fondit të pyetjeve për testimin e nxënësve të klasave të treta;

-Hartimi i instrumentave të vlerësimit me anë të post test-it për lëndën e TIK për klasën e parë dhe të dytë, për vitin shkollor 2024-2025

- Hartimi i instrumentave të vlerësimit me anë të pre-test-it për lëndën e TIK për klasën e tretë për vitin shkollor 2025-2026.

Kualifikimi i kërkuar

Ekspertët duhet:

- Të kenë mbaruar studimet e larta në fushën e mësuesisë në një nga degët Matematikë, Informatikë, Arsim Fillor.
- Të ketë eksperiencë jo më pak se 10 vite në mësimdhënie në arsimin parauniversitar.
- Të ketë njohuri mbi kurrikulën e lëndës së Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në arsimin fillor.
- Të ketë eksperiencë në mësimdhënie në arsimin fillor dhe/ose në fushën TIK.
- Të njohë përdorimin e platformës CodeMonkey
- Të ketë eksperiencë në projekte dhe veprimtari që lidhen me zhvillimin profesional të mësuesve në arsimin parauniversitar.
- Të jetë vlerësuar të paktën me vlerësimin “Shumë Mirë” në nivelet e kualifikimit.
- Të zotërojnë gjuhën Angleze.

Kërkesa të tjera

- Zotërim i aftësive për përdorimin e paketës Microsoft Office.
- Gadishmëri për punë gjatë fundjavëve.
- Gadishmëri për të lëvizur jashtë Tiranës.
- Zotërim i aftësive për përdorimin e pajisjeve të teknologjisë dhe platformave interaktive.
- Aftësi të mira bashkëpunuese dhe komunikuese.
- Aftësi të spikatura për punën në grup.

Raportimi

Raportimi do të zhvillohet në përputhje me përmbushjen e kriterëve të performancës në kontratën e shërbimit me Nr 1235/9 Prot, datë 19.05.2025, për projektin e bankës Botërore “Kryerja e shërbimeve me fonde buxhetore në kuadër të Projektit për përmirësimin e aksesit të barabartë në shërbimet publike me standard të lartë nëpërmjet OPERACIONIT GOVTECH”, (Aktivitetet me kodet 2.4.2, 2.4.3, 2.9.2, 2.9.3, 2.2.2, 2.2.3 dhe 2.2.4).

Pagesa

Pagesa e ekspertëve që do të angazhohen në përmbushjen e detyrave të parashikuara në kuadër të kësaj thirrjeje do të realizohet në përputhje me përcaktimet e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 120, datë 27.01.1997 “Për shpërblimin e autorëve të veprave shkencore, teksteve shkollore dhe materialeve të tjera të dokumentacionit shkollor”. Shuma përkatëse do të llogaritet mbi bazën e natyrës së kontributit të dhënë dhe në përputhje me nenet përkatëse të këtij vendimi.

Forma e Aplikimit

Dosja e aplikimit duhet të përmbajë:

- CV sipas formatit EuroPass;
- Kërkesë, ku eksperti duhet të japë motivimin, se pse është kandidati më i përshtatshëm për këtë konsullencë;
- Letër motivimi, ku të argumentohet interesi dhe gadishmëria për përmbushjen e detyrës;
- Një model të një instrumenti vlerësimi, ku të përfshihen të katër tematikat e kurrikulës së TIK për klasën e parë, të dytë ose të tretë të arsimit fillor;
- Fotokopje e diplomave dhe dëshmive/certifikatave të kualifikimit
- Fotokopje e pasaportë/kartë identiteti;
- Dëshmi penaliteti (ose formular vetdeklarimi).

Dokumentacioni i aplikimit duhet të dërgohet në formë shkresore, në një zarf të mbyllur të firmosur, me shënimin e thirrjes përkatëse që aplikon, në adresën:

Universiteti i Tiranës/ Protokolli

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Sheshi “Nënë Tereza”, Tiranë, Shqipëri.

Afati i aplikimit deri më: **datë 04.06.2025, ora 16:00.**